



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. 330 Prot.

Berat, më 19/01/2023

V E N D I M
Nr. 42 datë 19/01/2023
PËR

MIRATIM TË PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL
PËR VITIN 2023

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjes Vendore", neni 8 ,pika 2, neni 9 ,gërma b, të nenit 18 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin Civil", I ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimit në Shërbimin Civil", vendimit nr.724 date 13.12.2022 "Për miratimin e Strukturës, Organigramës së Administratës së Bashkisë dhe të Njësivë Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat", për vitin 2023 si edhe informacionin e Njësisë së Menaxhimit te Burimeve Njerëzore për pozicionet e lira të krijuara në shërbimin civil, Kryetari i Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Numri i pozicioneve vakante të punës në shërbimin civil , në administratën e Bashkisë Berat, për vitin 2023 do të jetë **12(dymbëdhjetë)** gjithsej sipas kategorive të mëposhtëme :

a)Për kategorinë ekzekutive **9(nëntë)** pozicione vakante

- Specialist i Auditit të Brendshëm , Sektori I Auditit të Brendshëm
- Specialist për Taksat dhe Tarifat në Lagje, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave
- Specialist për Taksat dhe Tarifat në Njësinë Administrative Sinjë , Drejtoria e Taksave dhe Tarifave
- Specialist i Financës dhe të Ardhurave, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave
- Specialist Prokurimesh, Drejtoria Juridike
- Specialist i Pronave dhe Strehimit, Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave , Transportit dhe Shërbimeve
- Specialist i Ndihmës Ekonomike dhe Pagesat e Aftësisë së Kufizuar në Njësinë Administrative Velabisht , Drejtoria e Shërbimit Social
- Specialist Turizmi dhe Trashëgimisë Kulturore, Drejtoria e Turizmit dhe Aktiviteteve
- Specialist i Protokollit dhe Ceremonialit zyrtar Drejtoria e Turizmit dhe Aktiviteteve

a.1)Për kategorinë e Ulët Drejtuese **2(dy)** pozicione vakante

- Përgjegjës për Çështjet Sociale
- Përgjegjës për Taksat & Tarifat e Biznesit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

a.2)Për kategorinë e Mesme Drejtuese I(një) pozicion vakant

- Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve

2.Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse , në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

Ervin Domo

